

Republika e Shqipërisë

Media: TVSH & Top Channel

Hyrje

Pamja e tanishme e tregut televiziv në Shqipëri dhe evolucioni i këtij tregu në vitet e fundit është mbresëlënëse. Deri në vitin 1995, për shumë shqiptarë media elektronike donte të thoshte vetëm radio dhe televizion shtetëror. Sot, sipas të dhënave zyrtare, në Shqipëri ka rreth 68 stacione televizive lokale, dy stacione televizive kombëtare, dy televizione satelitore, si dhe 44 televizione kabllore lokale. Përsa i përket stacioneve radiofonike, ka 46 të tilla lokale dhe dy kombëtare. Përveç kësaj, është edhe transmetuesi publik, RTSH, i përbërë nga TVSH, i cili transmeton në një program kombëtar dhe në tre programe lokale, si dhe Radio Tirana, e cila transmeton në dy programe kombëtare, katër lokale, një program për bashkëatdhetarët dhe një tjetër në gjuhë të huaj.

Për momentin ka dy stacione private televizive kombëtare: TV Klan, i krijuar në vitin 1998, që mbulon 43 përqind të territorit të Shqipërisë, si dhe TV Arbëria, e krijuar në vitin 1996, që mbulon 30 përqind të territorit. Mungesa e studimeve sistematike dhe shkencore të tregut e bën të vështirë përcaktimin e përqindjes së shikueshmërisë së transmetuesve në Shqipëri. Megjithatë, mbetet një fakt që Radio Televizioni Shqiptar (RTSH), transmetuesi publik, mbulon 80 përqind të territorit të vendit, megjithëse ulja e popullaritetit dhe shikueshmërisë së tij është i pranuar edhe nga administrata e RTSH.

Pra, tregu televiziv shqiptar ka parë nga njëra anë dobësimin e ndikimit të transmetuesit publik dhe nga ana tjetër ngritjen e vazhdueshme, edhe pse jo gjithnjë të lehtë, të stacioneve private televizive si burime informacioni dhe lojtarë në treg. Megjithatë, sukcesi jo gjithnjë është sinonim i lajmeve cilësore; ose edhe kur kjo është e vërtetë, si ndikojnë lajmet që i ofrohen shikuesit në formimin e perceptimeve dhe qëndrimeve publike? Për këtë qëllim, ky monitorim do të përqendrohet në tetë edicione kryesore të mbrëmjes gjatë muajit prill, të monitoruara në të njëjtat data si për transmetuesin publik dhe për një nga stacionet televizive private më të njohura.

Në mungesë të studimeve të rregullta të tregut për shikueshmërinë e stacioneve televizive, monitorimi do të përfshijë TVSH, transmetuesin publik, dhe Top Channel, stacion

privat. Edhe pse ky stacion nuk ka një licencë kombëtare, ai ka arritur të mbulojë një pjesë domethënëse të territorit me anë të ritransmetimit në kanale të tjera ose me mjete të tjera. Gjithashtu, ai konsiderohet si një nga tre televizionet më me ndikim në vend për shkak të lajmeve dhe disa programeve të tjera shumë të suksesshme. Monitorimi ka matur dhe analizuar ndër të tjera përmbajtjen sipas temave të ndryshme, shpërndarjes territoriale, formës, orientimin ndaj subjektit. Monitorimi ka përfshirë të gjithë edicionin kryesor të lajmeve plus disa kronika speciale të lajmëruara gjatë lajmeve dhe të transmetuara direkt pas tyre; parashikimi i motit është përjashtuar.

Analiza e përmbajtjes

Periudha e monitorimit përkoi me një atmosferë shumë të tensionuar dhe të ngarkuar në median shqiptare për shkak të dy zhvillimeve kryesore: paraqitja e një propozimi për projektligjin e transmetimeve dixhitale në parlament nga qeveria si dhe fërkimi mes qeverisë dhe një prej kompanive kryesore të medias përsa i përket kontrolleve financiare. Këto zhvillime ndikuan në mënyrë të ndjeshme në pasqyrimin e lajmeve gjatë këtij muaji, kështu që është e rëndësishme të shpjegohet shkurtimisht sfondi i këtyre zhvillimeve.

Më konkretisht, muaji prill shënoi paraqitjen e një propozimi nga qeveria në parlament të një projektligji për televizionin dixhital. Shqipëria deri në atë pikë kish qenë në një gjendje shumë të veçantë, pasi që prej tre vitesh ka një platformë të plotë satelitore dhe tokësore dixhitale dhe një platformë dixhitale satelitore, por vendi nuk ka ende një strategji dhe ligj për dixhitalizimin. Ka pasur përpjekje edhe në të kaluarën për të miratuar një ligj të tillë në parlament, por ato janë kundërshtuar nga forcat e ndryshme politike për arsye të ndryshme, mes një klime akuzash politike të ndërsjellta dhe mungese të përgjithshme kuptimi dhe debati për atë çka këto zhvillime do të sjellin në të vërtetë. Ndërkohë, Digitalb, kompania që operon platformën tokësore dhe satelitore, deklaroi një sukses mjaft të madh në treg.

Përpjekjet e fundit për të miratuar një projektligj për këtë temë nxitën një debat mjaft të ndezur që përfshiu pothuajse të gjitha stacionet televizive dhe veçanërisht Top Channel, objekt të këtij monitorimi. Arsyeja që Top Channel ishte veçanërisht i ndjeshëm është se pronari i stacionit është gjithashtu themelues dhe aksioner kryesor i Digitalb. Ky motivim u bë akoma më i fortë nëse i shtohet the fakti që kjo periudhë përkoi me vizita dhe kontrolle financiare të përsëritura nga policia tatimore në zyrat e Digitalb dhe ato të Top Channel. Këto zhvillime çuan në një betejë të hapur të stacionit me qeverinë, si dhe në pretendimin që qeveria po përpiqej të mbyllte televizionin sepse ai thoshte të vërtetën dhe kritikonte gabimet e qeverisë.

Për pasojë, kjo frymë ka formuar në mënyrë të ndjeshme të gjithë pasqyrimin e edicioneve të lajmeve të Top Channel; ashtu si mund të pritej, vetëm sporti, kultura dhe lajmet e jashtme nuk janë prekur nga marrëdhëniet e tensionuara midis Top Channel dhe qeverisë.

Raportimet e kontrolleve të policisë tatimore te Top Channel dhe Digitalb, së bashku me raportimet e procedurave të projektligjit dixhital në parlament përbëjnë shumicën e përqindjes në temën e cilësuar si “tjetër” dhe kjo kategori përbën një sasi të konsiderueshme, 31% të përqindjes totale në krahasim me temat e tjera. Kjo përqindje domethënëse është një tregues se si kjo temë ka ndikuar përzgjedhjen e lajmeve për këtë stacion. Për më tepër, mënyra se si kjo temë u pasqyrua nga stacioni tregon shumë për mënyrën se si edicionet e lajmeve ndikohen atëherë kur preken interesa të drejtpërdrejta.

Është interesante, por ndoshta jo e papritur, që vëmendja e transmetuesit publik për këtë temë është e papërfillshme: TVSH, transmetuesi publik, mezi arrin 5% në kategorinë e temave “të tjera” në krahasim me 31% të Top Channel, dhe madje edhe kjo përqindje nuk zihet ekskluzivisht nga këto dy tema që prekin kaq shumë Top Channel. Duke pasur parasysh këtë kontekst, trajtimi i pasqyrimin të këtyre dy temave si një histori e veçantë mund të hedhë më shumë dritë për të kuptuar strukturën, zgjedhjen dhe përparësitë e këtyre dy stacioneve televizive shumë të ndryshëm nga njëri-tjetri në këtë aspekt.

Projektligji për televizionin dixhital dhe kontrollet financiare: dy mënyrat e (mos)pasqyrimin të së njëjtës temë

Siç u përmend më sipër, shkalla dhe mënyra e pasqyrimin të këtyre dy temave në dy televizionet është pothuajse diametralisht e kundërt. Më konkretisht, transmetuesi publik nuk ka asnjë pasqyrim të kontrolleve financiare të bëra te Top Channel dhe Digitalb; këto nuk përmenden në asnjë edicion lajmesh, dhe nuk përmendet as tensioni që pasoi. Në fakt ky është një vendim i kuptueshëm, meqë këto zhvillime nuk prekin drejtpërdrejt dhe qartë interesin publik dhe mund të shihen edhe thjesht si marrëdhënie biznesi.

Megjithatë, gjendja nuk ndryshon shumë kur vjen puna te raportimet për projektligjin e transmetimeve dixhitale, edhe pse shpjegimi dhe analiza e politikave të lidhura me dixhitalizimin përbën interes publik, sidomos po të konsiderojmë që roli i transmetuesit publik kundrejt dixhitalizimit është një temë mjaft e nxehtë debati në erën tonë. Për shembull, 12 prilli, që ishte një nga ditët e monitorimit, ishte gjithashtu dhe një nga ditët kur parlamenti kishte një seancë mbi projektligjin dixhital, madje një seancë të ndezur. Por ajo që u shfaq në lajmet e TVSH, ishte që “seanca ishte e qetë dhe pa probleme,” përveç fjalës së zemëruar të mbajtur nga një deputet, ish-pjesëtar i grupit parlamentar të opozitës. Ky fjalim nuk përmendte në ndonjë mënyrë projektligjin në fjalë; fjalimi e drejtonte zemërimin e tij ndaj drejtorit të gazetës që kishte thënë se nuk kishte asnjë problem që partia opozitare të mbante kongresin atë ditë me dyer të mbyllura. Pra, TVSH vendosi të transmetonte pothuajse të plotë fjalimin e këtij deputeti që kritikonte drejtorin e gazetës dhe partinë në opozitë, por nuk përmendte aspak që po diskutohej një projektligj për transmetimet dixhitale dhe që rezultati do i prekte të gjithë, përfshirë këtu dhe TVSH. Fundi i kronikës mbyllej me një fjali që lajmëronte se parlamenti kishte ratifikuar një marrëveshje asistence dypalëshe mes Shqipërisë dhe

Bullgarisë në luftën kundër terrorizmit. Kjo patjetër që hyn te temat e rëndësishme, por këto lloj marrëveshjesh për publikun janë vetëm formalitete dhe, fatmirësisht, nuk janë të prekshme deri në këtë moment për publikun e gjerë, ndërsa numri i kanaleve dixhitale që do të jenë në gjendje të shohin të nesërmen shikuesit dhe me çfarë kushtesh padyshim që është më i prekshëm për ta.

Në mënyrë të ngjashme, në 20 prill Komisioni Parlamentar i Medias pati një seancë dëgjimore me grupet e interesit për projektligjin për televizionin dixhital. Ky lajm u transmetua në një mënyrë mjaft konçize nga TVSH, duke përmendur faktin që kishte një seancë dëgjimore për këtë çështje, me një sinkron nga Drejtori i Përgjithshëm i TVSH, i cili kërkonte frekuencat që ligji i ka rezervuar për transmetuesin publik, por pa asnjë thënie nga aktorët e tjerë të pranishëm aty, përfshirë këtu dhe pronarin e Top Channel dhe Digitalb, i cili është lojtari kryesor në treg.

Krejt ndryshe, Top Channel i ka ndjekur dhe pasqyruar këto dy tema hap pas hapi, duke transmetuar dhe editoriale dhe duke i çuar ato edhe përtej kufijve të vendit, ndonjëherë edhe në mënyrë paksa të sforcuar. Për shembull, ditën e kontrolleve të policisë tatimore ndaj Digitalb, Top Channel transmetoi një kronikë për vizitën e kryetarit të parlamentit belg Herman De Croo te homologia e tij shqiptare. Titulli i kronikës është “De Croo mbështet median,” duke lënë të kuptohet që aktorët ndërkombëtare mbështesin Top Channel në gjendjen e tanishme me qeverinë. Kronika përmendte se “takimi gjithashtu përfshinte dhe mediat si një pikë të rëndësishme dhe De Croo i dha një mesazh të rëndësishëm mbështetjeje medias.” Gjithashtu kronika përfshinte një citim nga një konferencë për shtyp e De Croo: “Tani që ju shoh e kuptoj sesa faktor i rëndësishëm është media në jetën politike shqiptare.” Kurse TVSH transmetoi një kronikë speciale pas lajmeve në të njëjtën ditë, e cila konsistonte në transmetimin e plotë të konferencës për shtyp të kryetares së parlamentit shqiptar dhe homologut të saj belg. Po të shihet citimi i përzgjedhur nga Top Channel në kontekstin e tij të plotë është shumë e vështirë të lidhësh citimin me situatën që po zhvillohej në media dhe qeveri atë ditë. Në fakt, citimi duket më tepër i lidhur me praninë e madhe të grupeve të xhirimit në sallën e konferencës, ashtu siç tregon qartë De Croo drejt njerëzve përballë tij, të cilët janë duke xhiruar ose intervistuar. Ky episod dëshmon për një mënyrë të veçantë të trajtimit të informacionit në një kontekst të caktuar nga televizioni në fjalë.

Një tjetër shembull që dëshmon për prirjen e shikimit të lajmeve nëpërmjet këndvështrimit të “Top-Channel” në këtë periudhë gjithashtu vjen nga e njëjta ditë. Top Channel përdori korrespondentët e tij në Kosovë për të intervistuar tre intelektualë kosovarë mbi temën e kontrolleve të përsëritura financiare të Digitalb dhe Top Channel në 3 prill. Titulli për këtë kronikë, pjesë e kronikës së zgjeruar për këto kontrolle, të cilat zinin pothuajse gjysmën e edicionit të lajmeve, ishte “Sulm mbi Top Channel: Reagime të forta në Kosovë.”¹

¹ Top Channel dhe platforma Digitalb mund të ndiqen në Kosovë dhe vende të tjera nëpërmjet satelitit, kështu që mund të thuhet se kjo çështje prek edhe shumë shqiptarë jashtë vendit.

Megjithatë, po të dëgjohen me vëmendje intervistat, ekziston një mospërputhje midis titullit alarmant dhe përmbajtjes së tij. Të treja intervistat shprehin keqardhje për situatën e tensionuar, por ata nuk bëhen palë të qarta në këtë çështje; të intervistuarit këshillojnë për vetëpërmbajtje dhe maturi nga të dyja palët. Kështu, Migjen Kelmendi, gazetar dhe analist, citohet duke thënë: “Ky qëndrim nuk është konstruktiv dhe nuk sjell asgjë të mirë,” ndërsa Xhavit Haliti, politikan, thotë se ai ka “besim te vullneti i mirë i kryeministrit dhe një media e kalibrit të Top Channel nuk ka pse të ketë frikë nga akuzat për evazion fiskal dhe duhet të dorëzojë dokumentat e nevojshme në polici.” Kjo mospërputhje e qartë mes titujve të fortë, sensacionalë e ndonjëherë edhe agresivë dhe përmbajtjes vihen re shpesh në edicionet e lajmeve dhe kjo prirje nuk është vetëm e Top Channel. Si e tillë, ajo meriton një vëmendje të veçantë.

Titujt kundrejt Përmbajtjes

“Sulm i paligjshëm: presion i paprecedent,” “Tatimorët sulmojnë Top Media-n,” “Policia përgatitet të hyjë me forcë në zyrat e Digitalb,” “Top Channel kundër qeverisë,” “Akademikët kundër Berishës²,” “Sulm ndaj Top Channel,” “Berisha kundër FMN,” “Lufta kundër Top Channel: Gjashtë muaj represioni politik dhe tatimor.” Këto janë disa nga titujt që janë shfaqur shpesh në edicionet e lajmeve të Top Channel, duke përshkruar një klimë të tensionuar, agresive dhe të ngarkuar që ekziston midis kësaj kompanie mediatike dhe qeverisë. Megjithatë, për hir të së vërtetës duhet thënë se disa nga këto tituj janë pjesë të editorialeve që Top Channel transmetoi në kulmin e krizës në prill dhe këto editoriale ishin të etiketuara qartë si të tilla. Megjithatë, në përgjithësi mund të thuhet se ekziston një prirje për të vendosur tituj që tërheqin vëmendjen duke ekspozuar agresivitet, dyluftim dhe në të njëjtën kohë duke përçuar një ndjenjë të përhershme tensioni dhe beteje të vazhdueshme.

Po të krahasojmë këto të fundit me titujt e TVSH, këto të fundit janë pak më të buta dhe nuk të lenë shijen e alarmit dhe gjendjen e luftës ashtu si titujt e Top Channel, gjë që është e kuptueshme po të kemi parasysh prirjet e raportimit të këtyre televizioneve. Megjithatë, nuk mund të thuhet se titujt e TVSH janë të përkryer dhe përputhen tërësisht me përmbajtjen. Për shembull, në 3 prill Këshilli Drejtues i RTVSH dorëzoi raportin vjetor në parlament. Kjo ngjarje u pasqyrua në edicionin e lajmeve me shpjegimin paraprak të folësit se “Deputetët i kërkojnë përfaqësuesve të TVSH të mbajnë premtimet e transformimit të transmetuesit në një televizion publik.” Kjo hyrje të bën të mendosh që do të ketë këshilla nga deputetët, madje edhe kritika ndaj administratës së TVSH. Megjithatë, dy citimet që pasojnë ia kalojnë përgjegjësinë për këtë gjendje në drejtime të tjera. Kështu, një deputet thotë: “Qeveria duhet të rishikojë buxhetin nëse i merr seriozisht institucionet e pavarura,” ndërsa citimi tjetër thotë se “është detyra ligjore e parlamentit të ndihmojë TVSH në rrugën e tij.” Kjo kronikë dhe citimet e saj jo vetëm që nuk mbështesin lajmërimin e kronikës, por ato shprehin

mbështetje ndaj vetë TVSH në gjithë këtë çështje, duke hedhur dyshime edhe për paanshmërinë e raportimit në këtë rast specifik. Objektiviteti është një nga treguesit kryesorë të lajmeve cilësore dhe mund të analizohet edhe më tej duke marrë në konsideratë përzgjedhjen e temave të kronikave dhe burimet e informacionit në to.

Kush flet dhe për çfarë

Me përjashtimin e pasqyrimin të projektligjit mbi transmetimet dixhitale dhe kontrollet qeveritare ndaj Top Channel, ngjarjet dhe temat e tjera të pasqyruara në të dyja televizionet ishin të ngjashme deri në njëfarë mase, sidomos në lidhje me politikën dhe ekonominë. Kështu, ligji i polemizuar mbi gjobat ndaj biznesit, reforma zgjedhore, zhvillimet brenda dy partive kryesore në vend, si dhe përcaktimi i statusit të Kosovës u pasqyruan gjerësisht nga të dyja stacionet. Megjithatë, mënyra e pasqyrimin, burimet e përzgjedhura, citimet, apo përparësia e lajmeve dhe citimeve në lidhje me këto tema ndryshojnë nga njëra-tjetra.

Për shembull, Majlinda Bregu, Ministre e Integritetit dhe Zëdhënëse e Qeverisë, dha një konferencë për shtyp në 21 prill. Titulli i TVSH për këtë kronikë ishte “Qeveria do të ndryshojë planin e zbatimit të MSA.” Ndërkohë që komentonte problemet e koalicionit qeverisës, pjesa kryesore e komunikimit të Bregut ishte mbi MSA. Krejt ndryshe, titulli i Top Channel përqendrohej te koalicioni dhe problemet e tij, duke mos përmendur pjesën për zbatimin e MSA. Në fakt, Top Channel i kushtoi një kronikë problemeve në koalicionin qeverisës, ku një nga partitë e vogla paraqiti disa kërkesa dhe kërcënoi të largohej nga koalicioni nëse qeveria nuk i plotësonte ato. Megjithatë, ky fakt i rëndësishëm në jetën politike, i cili hidhte dyshime mbi qëndrueshmërinë e qeverisë, nuk përmendet fare në TVSH; problemi i koalicionit u mjaftua me shpjegimin e dhënë nga zëdhënësjja e qeverisë.

Raste të tjera dallimesh në pasqyrim midis dy stacioneve përfshinin ligjin për gjobat. Ky projektligj i polemizuar solli një debat të ndezur, i cili përfshiu shumë përfaqësues të biznesit. Pati disa seanca dëgjimore në parlament për këtë çështje; pati një takim të qeverisë me grupet e interesit e kështu me radhë. Edhe pse pasqyrimi ishte pak a shumë i ngjashëm, titujt e Top Channel, por edhe përmbajtja, theksonin faktin që shumica qeverisëse ishte e vendosur të miratonte projektligjin edhe pse të gjitha grupet e interesit ishin deklaruar kundër. Nga ana tjetër, TVSH e përmendi këtë fakt, por në një mënyrë që përpiquej të zbehte këmbënguljen e qeverisë kundrejt aktorëve të tjerë. Megjithatë, kontrasti më i qartë në këtë aspekt kishte të bënte me dy raste raportimi. Kur pasqyruan takimin e qeverisë me grupet e interesit dy televizionet paraqitën si tituj, ashtu edhe këndvështrime të ndryshme. Titulli i TVSH ishte: “Uldedaj³ kërkon dialog mes qeverisë dhe biznesit.” Për të njëjtën ngjarje Top Channel kishte titullin: “Biznese pranë qeverisë kundërshtojnë projektligjin.” Në këtë rast

³ Uldedaj është Kryetar i Dhomës së Tregtisë.

publiku gjendet i hutuar për të vërtetën, edhe pse të dyja stacionet e transmetuan citimin e Uldedajt.

Këndet e ndryshme të së njëjtës ngjarje pothuajse gjithnjë ishin të lidhura me qeverinë, edhe atëherë kur citimet vinin nga një i huaj. Kështu, në 20 prill të dyja stacionet televizive transmetuan kronika mbi vizitën në Shqipëri të Michael Leigh, Drejtor i DG për Zgjerimin. Përmbajtja e Top Channel ishte pozitive, por e përmbajtur, duke theksuar që BE do të siguronte asistencë për Shqipërinë, por me kusht që të përmbushte disa kriterë. Nga ana tjetër, pasqyrimi i TVSH ishte më rozë, duke përmendur vetëm vlerësimet e Leigh për progresin e Shqipërisë dhe faktin që do të merrte ndihmë.

Së fundmi, një ngjarje tjetër nxjerr në pah dallimet në pasqyrimin e së njëjtës ngjarje në ato raste kur ka tema të ndryshme për të dyja stacionet. Duke pasur parasysh marrëdhëniet e tensionuara qeveri-media, vonesën në reformën zgjedhore, si dhe ligjin e polemizuar të gjobave, përfaqësues të shoqërisë civile u takuan me Presidentin në 12 prill. Megjithatë, po të krahasohet e njëjta kronikë në të dy stacionet mund të ngjajë edhe sikur i njëjti grup pati dy takime të ndryshme, për dy tema të ndryshme. Nuk ishte e papritur që Top Channel do t'i kushtonte pjesën më të madhe të kronikës asaj që folësi e quajti "sulm të qeverisë ndaj medias." Megjithatë, në fund kronika gjithashtu përmbante diskutime për reformën zgjedhore dhe marrëdhëniet qeveri-biznes. E njëjta ngjarje në TVSH përmbante deklarata të zgjeruara për reformën zgjedhore dhe nevojën për një regjistrim të popullsisë. Vetëm në fund të saj gazetari përmendi kalimthi se "përfaqësuesit e shoqërisë civile diskutuan gjithashtu edhe për gjendjen e tanishme të medias," por pa dhënë asnjë citim. Përshkrimi i këtyre dy kronikave është një shembull i qartë se si interesat editoriale të një media formojnë dhe ndikojnë të njëjtën ngjarje, duke sjellë rezultate që vështirë se krahasohen, me pasoja mjaft të ndryshme të publiku. Shumicën e kohës këto dallime konsistojnë në përzgjedhjen e temave dhe burimeve të informacionit, e sidomos në përparësinë e tyre; kështu që analizimi i edicionit të lajmeve të të dyja stacioneve televizive në këtë prizëm do të tregonte akoma më shumë se si përcaktohen lajmet në atë formë që i përcillen publikut.

Temat, burimet e informacionit dhe renditja: një çështje përparësish

Po të shikojmë përqindjet e pasqyrimin të temave të ndryshme në të dyja stacionet, përveç kategorisë "të tjera," të shpjeguar më sipër, në përgjithësi pasqyrimi i temave të ndryshme është i krahasueshëm dhe dallimet janë pothuajse të papërfillshme. Përjashtimet e vetme në këtë rast lidhen me temat e politikës së brendshme dhe atë të politikës së jashtme të vendit. Përqindjet e TVSH për këto dy tema janë respektivisht 24% dhe 11%, në krahasim me 15% për politikën e brendshme dhe vetëm 2% politikën e jashtme në Top Channel. Siç mund të shihet edhe nga numrat, zhvillimet politike në vend, qofshin të brendshme apo të jashtme, përbëjnë 35% të kohës totale të lajmeve kryesore në televizionin publik, që është një përqindje e rëndësishme. Kjo përqindje është dyfishi i 17% që zënë këto tema në Top

Channel. Është e rëndësishme të vërehet se të dyja stacionet në përgjithësi shfaqin një qëndrim neutral, duke arritur në masën 70% për TVSH dhe 83% për Top Channel. Megjithatë, detaje të tjera, si burimet e informacionit të përdorura, axhenda përtej lajmeve dhe prania e personave të ndryshëm në lajme japin një pamje më të plotë, që shkon më thellë sesa objektiviteti në pamje të parë.

▪ ***Përparësia e renditjes së lajmeve dhe burimet e informacionit***

Po të shohim nga afër strukturën e lajmeve, është e qartë që ka dallim mes dy televizioneve edhe në përparësitë e lajmeve. Për shembull, në të tetë edicionet e lajmeve të monitoruara në TVSH, të gjitha ato hapen me lajme nga qeveria, mundësisht me citime të Kryeministrit, të Ministrit të Punëve të Jashtme, ose ndonjë zyrtar tjetër të lartë të qeverisë. Përjashtimi i vetëm është edicioni i 11 prillit, i cili fillon me një intervistë të Sekretarit të Përgjithshëm të OSBE, i cili citohet duke vlerësuar progresin e Shqipërisë dhe në një mënyrë dhe të qeverisë. Krejt ndryshe, Top Channel vetëm njëherë e ka nisur edicionin e lajmeve me qeverinë, ose më mirë me ndryshimet në qeveri që po diskutoheshin: në 30 prill parlamenti votoi ndryshimet e dy ministrave në kabinet. Përndryshe, lajmi i hapjes në Top Channel alternohej midis projektligjit për transmetimet dixhitale, ligjit për gjobat e biznesit dhe kontrollit financiar ndaj medias. Sërish, dy pikat e përqëndrimit për të dyja stacionet janë mjaft të ndryshme, duke treguar kështu pozicionet dhe përparësitë krejt të ndryshme që ato kanë.

Në këtë aspekt, është e rëndësishme të vërehet prania e politikanëve në edicionet e lajmeve të TVSH dhe sidomos pasqyrimi dhe përzgjedhja e citimeve të tyre. Për shembull, në 11 prill, pas lajmit se George W. Bush do të vizitonte Shqipërinë në 10 qershor, ka një citim të gjatë të Kryeministrit, i cili ia atribuonte këtë vizitë suksesit të reformave të qeverisë, duke përmendur mbështetjen amerikane për zgjerimin e NATO-s, si dhe lehtësimin e afërt në regjimin e vizave. Ky ishte një citim i bërë në një mbledhje të qeverisë, i transmetuar i dyti, menjëherë pas vlerësimit të dhënë nga Sekretari i Përgjithshëm i OSBE për arritjet e Shqipërisë. Edhe pse ky u paraqit si lajm, është e pamundur të mos vësh re se si të dyja këto kronika ndihmojnë në ngritjen e imazhit të një qeverie të suksesshme. Gjithashtu duhet vërejtur se këto ishin lajmet hapëse të edicionit, edhe pse nuk përbënin lajm në kuptimin e ngushtë të fjalës, ose të paktën jo lajm për fillimin e edicionit: njëri lajm ishte intervistë në kuadrin e përvjetorit të OSBE, ndërsa tjetri ishte mbledhje rutinë e qeverisë, që nuk lajmëronte për gjë tjetër përveç vetëvlerësimit të qeverisë.

Siç mund të vihet re në të gjitha edicionet e TVSH, prania e Kryeministrit është një garanci që kjo ngjarje do të pasqyrohet. Jo vetëm kaq; pavarësisht nga natyra e ngjarjes, është e sigurt që Kryeministri do të jetë në qendër të vëmendjes. Për shembull, edicioni i lajmeve të 12 prillit u hap me raportimin e një mbledhjeje të ekspertëve të energjisë për shfrytëzimin e burimeve të ndryshme të energjisë. Kjo është një temë e njohur dhe tashmë në vëmendje të gjithë botës, sidomos në Shqipëri, e cila pak kohë më parë kaloi një krizë të vështirë për shkak të dimrit të thatë. Megjithatë, qendra e ngjarjes ashtu si paraqitej në lajme nga TVSH

ishite Kryeministri, duke nisur që nga lajmërimi: “Kryeministri kundërshton rritjen e çmimit të energjisë.” Kjo thënie ishte lajtmotivi i gjithë kronikës, duke kujtuar publikun vazhdimisht se kryeministri po bënte ç’ ishte e mundur që ata të mos paguanin më tepër. Kjo ishte e dukshme në citimin e gjatë të Kryeministrit, i cili ishte edhe i vetmi për atë kronikë, edhe pse ai po fliste para një salle të madhe plot me ekspertë për energjinë, të cilët mund të kishin një mendim të ndryshëm. Shembulli i dytë në këtë rast lidhet me raportimin e festimeve për ditëlindjen e Profetit Muhamed, të organizuara nga komuniteti mysliman në Tiranë, por sinkroni përfshinte në radhë të parë Kryeministrin, i cili mori pjesë në ngjarje, dhe më pas udhëheqësin fetar, i cili organizonte festimin dhe në njëfarë mënyre i jepte kuptim gjithë ngjarjes.

Në të njëjtën linjë arsyetimi, është e qartë që zëdhënësant e qeverisë gjithashtu e kanë të lehtë të shfaqen në edicionet e lajmeve. Megjithatë, ky nuk është fenomen që kufizohet vetëm te TVSH: në lajmet e 21 prillit të dyja stacionet i lanë hapësirë komunikatës për shtyp të Ministrisë së Arsimit për reagimet ndaj projektligjit për arsimin. Megjithatë, duket se televizioni publik e ka më pak problem të lërë të dëgjohet zëri i zëdhënësave të qeverisë: në edicionet e lajmeve të 21 prillit fjala e një zëdhënëseje të njëres prej ministrive u transmetua e plotë. Ajo mohonte aludimet e bëra kundër shefit të saj në një gazetë të përditshme; menjëherë pas këtij lajmi folësi lexon edhe komunikatën për shtyp të zëdhënësit të Kryeministrit për të njëjtën çështje. Megjithatë, ajo që të bën përshtypje është që për edicionet e lajmeve duket e rëndësishme vetëm të mohohen aludimet, paçka se publiku mund të mos jetë fare në dijeni të akuzave në shtyp.

Megjithatë, për hir të vërtetës, duhet thënë se prania e qeverisë dhe shumicës në pushtet është më e theksuar në edicionet e TVSH, por nuk është se këto lajme kufizohen vetëm me një anë të medaljes. Për shembull, për diskutimet e vazhdueshme mbi reformën zgjedhore, ligjin për gjokat, zgjedhjen e presidentit, të dyja anët janë paraqitur dhe këto kronika pak ndryshojnë nga ato të Top Channel, me disa përjashtime. Megjithatë, ashtu si tregon dhe përqindja e temave politike në lajmet e TVSH, të jesh politikan do të thotë që ekziston një mundësi e madhe për t’u pasqyruar në TVSH. Kështu, në edicionet e lajmeve të transmetuara nga TVSH në 29 dhe 30 prill, kishte kronika të përqëndruara tek ish-kryeministri Fatos Nano. Edhe pse deri vonë një person shumë i rëndësishëm, për këtë moment Nano nuk është shumë aktiv në parti dhe rrallë vjen edhe në parlament. Pra, do të ishte e vështirë të shpjegoje praninë e tij në lajme. Kjo bëhet akoma më e vështirë po të shohim se ai nuk kish ndonjë deklaratë të posaçme: kronikat ishin për dy takime që ai pati me një grup deputetësh spanjollë dhe me një politikan kosovar. Meqë ai nuk ka ndonjë pozicion zyrtar ose ndonjë ndikim zyrtar në vend për momentin, ose të paktën jo hapur, pasqyrimi i këtyre takimeve pune rutinë nuk shpjegohet aq qartë.

Në fakt, edicionet e lajmeve të TVSH kanë disa kronika rëndësia e të cilave nuk është aq e dukshme sa të kuptohet se pse ato meritojnë të jenë lajme. Këto lajme pothuajse gjithmonë janë për qeveritarë dhe takimet e tyre të punës, por takime rutinë. Është interesante që këto takime nuk kufizohen vetëm te qeveritarët, por përfshijnë edhe ambasadorin amerikan. Për

shembull, në 3 prill TVSH informon për një takim të Ministrit të Kulturës me ambasadorin e SHBA. Takimi nuk kish ndonjë fokus ose lajmërim të veçantë përveç zotimeve të zakonshme për bashkëpunim dhe asistencë të vazhdueshme. Kronika mbyllet duke përmendur se më pas ministri u takua me skuadrën e peshëngritësve dhe u uroi atyre sukses. Është e vështirë të gjendet ndonjë vlerë për lajm në këtë informacion me përjashtim të pranisë së ministrit në lajme, gjithmonë nëse kjo përbën një vlerë të mirëfilltë në aspektin e lajmit. Në mënyrë të ngjashme, në edicionin e lajmeve të 12 prillit TVSH raporton për vizitën e ambasadores së SHBA në Shkodër. Sërish, nuk kishte asnjë përvjetor, përrim, ose ndonjë ngjarje tjetër publike me vlerë për t'u raportuar: ambasadorja takoi prefektin, një grup studentësh dhe OJQ të zonës, duke lajmëruar dhe thirrjen për propozime për projekte, gjë që është një veprimtari rutinë që ndodh çdo vit. Në tërë këto elemente është vështirë të dallosh ndonjë gjë tjetër përveç lajmeve të protokollit.

Në mënyrë të ngjashme, nëse krahasojmë përqindjen e temës së politikës së jashtme të vendit, në TVSH ajo arrin 11% në krahasim me vetëm 2% në Top Channel. Ky gjithashtu është një tregues i pranisë së theksuar të politikanëve dhe citimeve dhe veprimtarive të tyre në TVSH. Kjo gjë gjithashtu vërehet lehtë po të shohim se nga katër speciale që transmetoi TVSH pas lajmeve, të gjitha ato të paralajmëruara gjatë lajmeve, vetëm njëra ishte me një pjesëtar të opozitës. Tre të tjerat kishin të bënin me Kryetaren e Parlamentit, Presidentin, ose konferenca të përbashkëta për shtyp të zyrtarëve të huaj dhe atyre shqiptarë. Edhe pse nuk ndodh gjithnjë kështu, ekziston një prani e lartë e lajmeve protokollare për këtë temë, si për shembull listimi i takimeve të Ministrit të Punëve të Jashtme në Nju Jork në 3 prill, pa citime ose ndonjë informacion përshkrues për rezultatet e takimeve.

Krejt ndryshe, është shumë e vështirë të dallosh lajme protokollare në Top Channel; në fakt, për shkak të marrëdhënieve të tensionuara me qeverinë lajmet e këtij stacioni ndonjëherë duket sikur shkojnë në ekstremin tjetër, në pikën ku shumë pak veprimtari të qeverisë ia vlejnë të raportohen. Kështu, ndërsa TVSH raporton për një konferencë të përbashkët për shtyp të Ministrit të Financave dhe Bankës Botërore për vendimin për të dhënë një kredi të rëndësishme për Shqipërinë, kjo nuk përmendet fare në lajmet e Top Channel. Në vend të kësaj, në kulmin e kontrolleve tatimore ndaj Digitalb po atë ditë, raportimi i vetëm që jepet është pyetja e gazetarit të Top Channel për ministrin në lidhje me këtë çështje në një konferencë për shtyp që nuk ka lidhje me këtë gjë.

Ky është një shembull tipik i natyrës specifike të temave të pasqyruara në Top Channel në këtë periudhë: siç u përmend më sipër, 35% e jetës politike në TVSH mund të krahasohet me 31% të temës “të tjera” në Top Channel, duke përfshirë kryesisht projektligjin për transmetimet dixhitale dhe kontrollet financiare kundër këtij stacioni nga tatimorët. Siç mund të kuptohet, zgjedhja e burimeve të informacionit dhe personave në lajme është e ndryshme nga ajo e TVSH. Këto zëra përbëhen kryesisht nga menaxhimi i Top Channel si dhe nga persona të tjerë miq ose mbështetës, si deputetë, avokatë, etj. Edhe aktorët ndërkombëtarë të përmendur më sipër, letrat nga Europarlamentarë, etj, përbëjnë një grup që dëgjohej

shpesh në këtë kontekst. Në kulmin e krizave lajmet dhe komentet e lajmeve për projektligjin ose kontrollet tatimore zinin më tepër se gjysmën e edicionit të lajmeve, duke i kthyer problemet e këtij stacioni në probleme të gjithë publikut.

Në të njëjtin arsyetim, ka disa ngjarje që shfaqen në lajmet e Top Channel në këtë periudhë, ndërkohë që në rrethana të tjera ka të ngjarë të mos transmetoheshin. Për shembull, në luftën e shpallur mes Top Channel dhe qeverisë dhe në sfondin e zotimeve të qeverisë për të luftuar informalitetin, ka një citim nga kryetari i sindikatës së gazetarëve shqiptarë në një takim në Fier në 2 prill, ku përmendet se shumica e punonjësve të Top Channel kanë kontrata pune. Nuk ka asgjë të çuditshme në këtë lajm deri në momentin kur marrim parasysh se unioni ka bërë shpesh takime për këtë qëllim në shumë qytete të tjera më parë dhe ato nuk janë shfaqur ndonjëherë në lajmet e Top Channel deri në këtë moment.

▪ ***Pasqyrimi i temave “të dobishme sociale” dhe çështjet e etikës***

Një praktikë më flagrante dhe e dyshimtë nga ana etike në këtë aspekt është kronika për një familje me tre djem të paralizuar nga një sëmundje gjenetike, e transmetuar në 11 prill. Ndër fakte të tjera kronika përmend se pavarësisht varfërisë së familjes, dëfrimi i vetëm i fëmijëve që vuanin ishte të shihnin Digitalb, kështu që prindërit e tyre blinin kartën e abonimit çdo muaj.

Megjithatë, në një aspekt më pozitiv, ka disa përpjekje për një gazetari qytetare, ose më mirë, përpjekje për të ndërgjegjësuar lidhur me disa tema sociale. Në këtë rast, gazetarja, megjithë qëndrimin paternalist ndaj “djemve fatkeqë,” përcjell rastin e njerëzve që vuajnë nga natyra dhe nga varfëria dhe i ndihmon ata në thirrjen e tyre për ndihmë. Në lidhje me një tjetër temë të rëndësishme për shëndetin, kancerin e gjirit, TVSH transmeton një intervistë me një të mbijetuar ndaj kancerit, me qëllim që të ndërgjegjësojë nëpërmjet përvojës vetjake publikun. Megjithatë, me gjithë qëllimin e mirë dhe rëndësisë së temës, kronika nuk ka statistika për këtë temë ose mendime apo këshilla të tjera nga doktorët, edhe pse, paradokalisht, këto do të ishin shumë më të lehta për t’u marrë sesa përvoja personale e një ish-të sëmure.

Në përgjithësi mbrojtja sociale dhe shëndetësia nuk zënë një hapësirë shumë të rëndësishme në edicionet e lajmeve, megjithëse nuk janë tërësisht të papërfillshme: ato arrijnë 7% për TVSH dhe 9% për Top Channel. Përveç kësaj, megjithë rëndësinë e qartë që u jepet disa ngjarjeve dhe temave në lajme, nuk ka një skemë të qartë në këtë aspekt dhe ky sektor nuk është i konsoliduar përsa i përket shpeshësisë dhe mënyrës së pasqyrimit. Për shembull, kohët e fundit ka pasur lajme “të çuditshme” në lidhje me rastet e peshkaqenëve afër Durrësit. Përveç natyrës së pazakontë të lajmit, ky informacion është mjaft me interes për publikun, duke pasur parasysh që kjo është nga zonat më të populluara të bregdetit në Shqipëri dhe rreziku është i qartë. Megjithatë, lajmi shfaqet në Top Channel në 20 prill, por jo në televizionin publik. Në mënyrë të ngjashme, dhuna kundër arbitrave në stadione ka qenë

një temë e rëndësishme së fundmi dhe u raportua nga Top Channel në 29 dhe 30 prill, por TVSH u përqëndrua vetëm te kampionati i lojrave në tavolinë për të rinjtë, pa e përmendur këtë problem serioz.

Çështjet e mbrojtjes sociale nuk janë aq të mëdha në numër në këto edicione lajmesh sa që të shqyrtohet çështja e etikës. Mëgjithatë, ajo që të bie në sy në dy kronika është që fëmijët shfaqen në televizion dhe flasim, edhe pse nuk identifikohen me gjeneralitete. Në dy raste shfaqja e tyre mund të justifikohet në emër të ndërgjegjësimit të interesit publik dhe mbështetjes për një të mirë më të madhe, si në rastin e viktimave të izoluar nga gjakmarrja në TVSH në 3 prill ose ai i një fshati që vuan pasojat e tërmetit në 20 prill në Top Channel.

Përfshirja e vetme me pikëpyetje në këtë aspekt janë intervistat e nxënësve të një gjimnazi në Top Channel në lidhje me akuzat ndaj mësuesit të tyre për shitje CD që përmbanin material për fizikën por edhe foto ose lojra erotike, të transmetuara në 29 dhe 30 prill. Edhe pse ishte e qartë që fëmijët kishin rënë dakord të flisnin që më përpara dhe nuk ishin nën presion, është e diskutueshme nëse ata duhen identifikuar me fytyrë duke pasur parasysh temën. Një pyetje po aq e rëndësishme është se pse ky lajm nuk u shfaq fare në televizionin publik, edhe pse publiku ka nevojë të dijë nëse ka ndonjë rrezik diku pranë fëmijëve.

▪ **Lajmet e “pakicës”**

Në këtë kontekst është gjithashtu e rëndësishme të vihet në dukje që nuk ka lajme për të rinjtë ose fëmijët dhe as për shkencën në asnjë nga televizionet; gjithashtu nuk pasqyrohen fare krimet e luftës në TVSH dhe ngjarjet fetare në Top Channel. Nga ana tjetër, TVSH duket se ka një përparësi më të madhe ndaj sektorit të kulturës: ai zë 9% në krahasim me 2% në Top Channel. TVSH informon rregullisht për shfaqjet e reja në Teatrin Kombëtar, në opera, etj. Megjithatë është interesante të vihet re se këto ngjarje nuk ndiqen deri në fund pas lajmërimeve. Nuk ka raportim për suksesin apo dështimin e shfaqjen, një mangësi që nuk është tipike vetëm për këto televizione, por në përgjithësi për median shqiptare, së cilës i mungon tradita e raportimit të kulturës apo kritika në këtë aspekt.

Në një vërejtje më negative, në disa nga raportimet e kulturës duket sikur ka një interes të qartë të TVSH ose raportimi i gazetarit shkon më tej se detyra e vet. Për shembull, në 3 prill TVSH raportoi për daljen e një CD nga një violinist shumë i njohur, duke përmbledhur interpretimet më të mira. Duke lënë mënjanë arsyen e zgjedhjes së kësaj CD ndër shumë të tjera, pasi këto ngjarje ndodhin shpesh, mbetet gjithashtu e paqartë pse gazetari duhet të përmendë edhe firmën e distribuicionit të CD, duke thënë se “shumëfishimi i CD u bë nga

kompania Antika, me qendër në Kosovë, dega Tiranë.” Më pas ka edhe një intervistë të shkurtër me përfaqësuesin e kompanisë, gjë që publikut vështirë se i hyn në punë.

Në po të njëjtën linjë, në 11 prill ka një intervistë të gjatë me një këngëtare dhe një fotograf të mirënjohur, të cilët flasin për dy ngjarje: organizimin e Miss Universe në Tiranë, (i cili do transmetohet nga TVSH, e cila është dhe organizatore) dhe koncertin e këngëtares në Amerikë (i cili do të transmetohet po atë mbrëmje menjëherë pas lajmeve). Edhe pse të dyja këto ngjarje mund të jenë me dobi dhe me interes për publikun, shtrohet pyetja nëse publiku do të informohet për këto ngjarje nëse TVSH nuk do të ishte e përfshirë në to, ashtu si ndodh pa dyshim edhe me ngjarje të tjera që ndodhin në vend. Në fakt, prirja e vetme që duhet qartë është se nuk ka një pasqyrim të rregullt të kulturës si të tillë; më tepër ky pasqyrim përcaktohet nga axhenda e organeve shtetërore që merren tradicionalisht me kulturën dhe nga vetë ngjarjet kulturore të TVSH.

E njëjta gjë vlen edhe për atë përqindje të vogël të kulturës dhe artit që pasqyrohet në lajmet e Top Channel. Lajmet atje lidhen me këngëtarët e Top Fest, një ngjarje e përvitshme, një festival muzikor shumë i njohur tek të rinjtë, i organizuar nga vetë Top Channel. Kësisoj, ashtu si dhe me tema të tjera, arti dhe kultura nuk i shpëtojnë dot ndikimit të interesave të përgjithshme të vetë televizioneve, si në Top Channel, ashtu edhe në TVSH.

▪ **“Pakicat” në lajme**

Një tjetër karakteristikë e rëndësishme e edicioneve të lajmeve në të dyja stacionet është shpërndarja gjeografike e lajmeve ose më mirë sa të gatshëm dhe të interesuar janë ata të shpërndahen në publikun e tyre. Po të shohim përqindjet nuk ka një dallim të qartë mes transmetuesit publik dhe atij privat: pasqyrimi i jugut dhe i veriut ka shumë pak ndryshim, nga 4 dhe 6% respektivisht për TVSH në 8 dhe 3% për Top Channel; pasqyrimi i Tiranës luhetet nga 16% për TVSH në 18% për Top Channel, pasqyrimi i përgjithshëm i vendit⁴ është 58% për TVSH dhe 52% për Top Channel, dhe ka saktësisht 10% të pasqyrimin të vendeve fqinjë për të dyja televizionet. Siç mund të shihet nga këto përqindje, Tirana zë një hapësirë të rëndësishme në edicionet e lajmeve; kjo përqindje është po aq e rëndësishme për transmetuesin publik, edhe pse supozohet që ai duhet t’i drejtohet dhe t’i shërbejë popullsisë së mbarë vendit. Në fakt, ekzistojnë përpjekje për të mbuluar qytete dhe zona të tjera përveç Tiranës në TVSH, i cili ka dy studio në Korçë dhe Shkodër, të cilat kanë raportuar me lidhje direkte. Gjithashtu ka dhe kronika për tema të ndryshme në zona përtej Tiranës, si për shembull dëmi ekologjik i liqenit të Shkodrës, përpjekjet e bletërritësve në Kukës, zhvillimet e turizmit në Pogradec dhe në Sarandë, etj. Megjithatë, rrallë ndodh që të ketë kronika spontane ose që një problem të ndiqet vazhdimisht kur vjen puna për tema të rëndësishme

⁴ Ky pasqyrim lidhet me ngjarje që ndodhin në Tiranë, por prekin të gjithë vendin, në përgjithësi duke përfshirë veprimtaritë e parlamentit, qeverisë, presidencës, si dhe institucioneve të tjera shtetërore, veprimtarive të shoqërisë civile, grupeve të ndryshme të interesit, etj.

për komunitetin e zonës, gjë që nuk përputhet me rolin e televizionit publik. E njëjta gjë vlen edhe për rajonet e tjera në Top Channel, edhe pse ky i fundit nuk është i detyruar të përmbushë disa detyrime publike ashtu si TVSH.

Megjithatë, ajo që vërehet në këtë aspekt është se axhenda që përcakton lajmet nuk ndjek një skemë shumë të ndryshme nga ajo e Tiranës: shumë shpesh ndodh që sa herë që politikanët bëjnë vizita në qytete të tjera, mitingje, ngjarje me rëndësi ekonomike apo politike në Tiranë apo qytete të tjera, shanset që ata do të jenë pjesë e lajmeve kryesore janë të mëdha. Për shembull, vizita e kryetarit të opozitës Rama në jug të vendit u pasqyrua në të dyja televizionet, ndërkohë që nuk kish asnjë raportim për ndonjë aspekt tjetër të jetës së njerëzve të thjeshtë në ato zona. Në fakt, ka gjithnjë e më pak hapësirë për zërin e njerëzve që nuk përfshihen në ndonjë aktivitet “me rëndësi madhore.”

Gjithsesi, nuk mund të thuhet kurrëse se nuk ka qytetarë në lajme dhe e gjithë hapësira iu lihet politikanëve apo zyrtarëve të qeverisë. Kronika që ndërtohet vetëm me intervistat e qytetarëve janë të shpeshta në lajme. Kjo është gjithashtu e qartë në përqindjen e lajmeve që vjen në formë sondazhi apo interviste: 16% në TVSH dhe 12% në Top Channel. Kjo përqindje gjithashtu përfshin intervista të shumta me politikanë, të cilët zënë hapësirën më të madhe në këtë pikë; megjithatë, ekzistojnë hapësira edhe për njerëzit e thjeshtë. Për shembull, Top Channel transmetoi një kronikë për veprimtarinë e biznesit në Tiranë, duke intervistuar shumë pronarë dyqanesh në lidhje me kasat e regjistrimit. Po ashtu, TVSH kishte një kronikë për çmimin e taksive në Tiranë, duke intervistuar si shoferat e taksive, ashtu edhe konsumatorët. Megjithatë, mbetet fakt që ajo pjesë e lajmeve që përfshin dhe u drejtohet së pari qytetarëve mbetet një pakicë në krahasim me ato lajme që përfshijnë qytetarë jo aq të thjeshtë.

▪ ***Prania e lajmene ndërkombëtare***

Ashtu si lajmet e brendshme, lajmet e jashtme nuk kanë një gjeografi shumë të larmishme. Ato variojnë nga 9% të hapësirës në Top Channel deri në 13% në TVSH. Siç mund të kuptohet, Kosova zinte vendin më të rëndësishëm në këto lajme, herë pas here duke transmetuar dhe intervista me udhëheqësit ose qytetarët e Kosovës, sidomos në Top Channel, i cili ka korrespondentë atje.

Megjithatë, përveç shumicës së lajmeve që përfshinin Kosovën, TVSH transmetoi një përzgjedhje të lajmeve të jashtme më pak të zakonshme. Këto lajme lidheshin me rajonin, pra me vendet e Ballkanit, dhe kishin tema shumë specifike. Kështu, u transmetua një kronikë për një simpozium ballkanik për teologjinë në Sarajevo, në 11 prill, megjithëse nuk u duk ndonjë përfaqësues shqiptar; u transmetua një kronikë për vizitën e Komisionerit Frattini në Kroaci dhe komentet e tij për statusin e integritetit të Kroacisë; po atë ditë kishte një kronikë për

arrestimet e policisë kroate për trafikun e qenieve njerëzore; dhe në 29 prill kish një kronikë për vdekjen e ish-Kryeministrit kroat. Nuk do të kish asnjë problem nëse këto lajme do të ishin pjesë e një reviste informative televizive për lajmet rajonale, por është pak më e vështirë të justifikohet kjo përzgjedhje si lajme të jashtme në edicionin kryesor të lajmeve. Një shpjegim i pjesshëm mund të jetë fakti që të gjitha këto janë lajme të EBU dhe TVSH, duke qenë anëtar, i ka të gatshme për përdorim të vetin. Megjithatë, mbetet e diskutueshme nëse këto lajme përbëjnë interes për publikun e gjerë në këtë lloj përzgjedhjeje.



Përfundimet



Në përgjithësi ka një ngjashmëri në edicionet kryesore të lajmeve si në stacionin publik ashtu dhe në atë privat për sa i përket larmisë së temave, por ka ndryshime në detaje, burime, si dhe në përparësinë e pasqyrimit. Përzgjedhja e lajmeve kryesore të mbrëmjes, po të shihet në kontekstin e zhvillimeve specifike, tregon një axhendë të veçantë që përcakton edhe kriteret e lajmeve. Përparësia kryesore e axhendës, ashtu siç dëshmon vetë rendi i vendosjes, përzgjedhja, si dhe burimet e informacionit, është shumë pranë axhendës së qeverisë ose politikës në përgjithësi ose pranë axhendës së menaxhimit të televizionit dhe interesat e tij të momentit. Në fakt, siç u tregua vazhdimisht gjatë analizës së monitorimit, prania politike e personave që nxisin një interes specifik për stacionin është një nga kriteret kryesore që përkufizon dhe vlerën e lajmit.


Për rrjedhojë, ndjekja nga televizionet e përparësive dhe interesave të lartpërmendura ka pasojat e saj tek temat dhe përfaqësimi social, si dhe në larminë e temave që u ofrohen publikut. Megjithë përpjekjet serioze që janë bërë në lidhje me temat me rëndësi sociale, pasqyrimi i tyre zakonisht është reagim ndaj tragjeditive ose ndaj ngjarjeve që kanë në qendër figura të rëndësishme, duke ofruar kështu pak mundësi për ndjekje të problemit ose për një analizë më të hollësishme të problemeve që prekin njerëzit që shohin lajmet çdo ditë.

Grafiket:

TVSH







Top Channel

